

ZYHDI DERVISHI**AT AMBROZ MARLASKAJ – ERUDIT ME VIZIONE
FILOZOFIKE DHE SOCIOLOGJIKE PËRHERË AKTUALE***

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore në përkujtim të veprimtarisë së At Ambroz Marlaskaj. Ka lindur më 19.11.1884 në fshatin Kushnen të Mirditës. Emri i tij i pagëzimit në lindje ka qenë Llesh Marlaskaj. Mësimet e para i mori në Kuvendin Françeskan të Rubikut. Përfundoi studimet e larta për teologji dhe në vitin 1908 u shugurua prift françeskan. Duke qenë se kishte aftësi të rralla si metodist mësimdhënës, ai caktohet pedagog kolegësh dhe punon fillimisht në kolegjet austriake dhe në Pragë. Në vitin 1910 kthehet në atdhe dhe caktohet sekretar i Provincës Françeskane të Shqipërisë me seli në Kuvendin Françeskan të Gjuhadorit (Shkodër). Në vjeshtë të vitit 1912 dërgohet me shërbim në Kosovë, në famullinë e Zllokuçanit. Më 1918 shërben si drejtor i Kolegjit Françeskan të Troshanit. Në vitet 1920-1924 përfshihet aktivisht në jetën politike të vendit, gjithnjë në ballë të forcave politike më përparimtare. Ishte një nga deputetët më autoritarë në Asamblenë Kushtetuese të vitit 1924. Në shkurt 1925 arratiset në Itali. Këtu mbron në gjuhën latine, tezën e doktoratës në fushë të teologjisë e të moralit.

Në vitin 1933 arrestohet, me pretekstin se në një predikim në kishën e Arrës së Madhe kishte thënë se katolikët nuk duhet t'i arsimojnë fëmijët në shkollat shtetërore. Pasi u lirua nga burgu, ai u internua në Vlorë e më vonë në Elbasan. I kërcënuar nga një arrestim i dytë detyrohet të largohet nga Shqipëria dhe në shtator të vitit 1934 fillon punën si lektor i teologjisë morale në Universitetin "Antonian" të Françeskanëve në Romë. Si kundërshtar aktiv i çdo diktature dhe si prift me "guxim djaloshar dhe atlet bese e atdhetarie" (Revista "Hylli i Dritës", 1939, nr. 3-7, f. 343). At Ambroz Marlaskaj kundërshtoi pushtimin fashist të Shqipërisë. Në qershor 1939 shtrohet në spital në Romë dhe operohet për apendisit. Dyshohet se operacioni ishte "planifikuar" të mos dilte me sukses, si kundërpërgjigje ndaj antifashizmit të tij. Këtë dyshim e qarkulluan kolegët e miqtë e tij, sidomos ata që jetonin si mërgimtarë në Romë. Hija e dyshimit ndjehet në mes rreshtave edhe në artikullin e botuar nga Gjon Kamsi në revistën "Hylli i Dritës", me rastin e vdekjes së At Ambroz Marlaskaj: "Ishte për ne të mërguemit një vdekje e papritun e përnjihëri edhe tepër e kobshme..." (1937, f. 342). Ndër shqiptarët, veçanërisht ndër ata të veriut, vdekja normale nuk quhej e kobshme. E kobshme edhe sidomos tepër e kobshme, quhej një vdekje e shkaktuar nga të tjerët, të nxitur nga qëllime të liga (Ky jetëshkrim i shkurtër bazohet kryesisht në të dhënat e shkrimeve

Trashëgimia e shkruar e At Ambroz Marlaskajt ngjan me një monument solid, që nuk mund të mbulohet nga pluhuri i harresës së imponuar, dhe as nga rrjedha e trazuar disadhjetërvjeçare e kohës.



Përkundrazi, idetë e kohëve të reja, duke u reflektuar dhe duke u përqsar në këtë korpus mendimi koherent, marrin impulse zhvillimi, korrektohen dhe rivlerësohen në dinamikën e përditësimit të tyre.

Duke qenë një njohës i thellë i kulturave më ndikuese në zhvillimet botërore në gjithë përmasat e tyre, si dhe i realitetit shqiptar aq kompleks, i prirur nga pikësynimi fisnik për “një përparim e përmirësim të vërtetë të vendit” , në shkrimet e tij At Ambroz Marlaskaj do të shtjellonte edhe një gamë të gjerë idesh filozofike e historike, kulturologjike e pedagogjike, psikologjike e sociologjike etj., të cilat karakterizohen jo vetëm nga saktësia e argumentimeve shkencore, por edhe nga vizione të gjera parashikuese.

Që në themelimin e shtetit shqiptar më 1912 dhe veçanërisht pas Kongresit të Lushnjës u përvijua dhe u thellua ndarja e veprimtarisë së strukturave shtetërore nga ajo e organizatave fetare. Kjo prirje është karakterizuar si shprehje e shekullarizimit, e modernizmit properëndimor të shoqërisë shqiptare të atyre viteve¹. Laiciteti i shtetit u përkrash kryesisht nga forcat politike dhe elementët më përparimtarë të atyre viteve, në radhët e të cilëve bënte pjesë edhe At Ambroz Marlaskaj. Edhe në këtë klimë debatesh pro dhe kundër laicitetit të shtetit, At Ambroz Marlaskaj, duke qëndruar gjithnjë në ballë të lëvizjeve përparimtare, arsyetonte me argumente filozofike e sociologjike funksionet shoqërore të besimeve fetare. Qysh në vitin 1922 ai shkruante: “Nji shtet i pa besim

“Patër Ambrozi” dhe “Deka e A. Ambroz Marlaskaj”, të botuar përkatësisht në “Hylli i Dritës”, 1939, nr. 3-7 dhe “Kumbana e së Diellës”, 1939, nr. 7 si dhe në broshurën “Fati i një dijetari” të shkruajtur nga Pal Doçi).

¹ Roberto Morocco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, Shtëpia Botuese “Elena Gjika”, Tiranë, 1994, f. 33.

u hap dyert herët a vonë dy të zezave mâ të mënershmëve të shoqnis, d.m.th. *despotizmit e anarkizmit*².

Rrokullima e ngjarjeve në historinë shqiptare përgjatë më se tetëdhjetë viteve të fundit ka dëshmuar vërtetësinë e këtij vegimi parashikues. Dobësimi i ndikimit të besimeve fetare si rrjedhojë e procesit të shekullarizimit dhe, akoma më keq, ndalimi i dhunshëm i tyre nga shteti socialist totalitar gjatë viteve 1967-1990, jo vetëm e varfëroi së tepërmi botën shpirtërore të shqiptarëve, por, siç ka argumentuar për rrethana të tilla sociologu William Samner, e zhveshi atë nga forca vetëkontrolluese që imponon së brendshmi, pa sforcim e në mënyrë të natyrshme zbatimin e kërkesave të normave kulturore, ligjore etj.³ Zbrazëtia e krijuar do të kompensohej në mënyrë të pashmangshme me intensifikimin e imponimit së jashtmi, në formën e dhunës represive despotike të organeve shtetërore të diktaturës së proletariatit mbi nënshtetasit e vet. Kjo ishte vetëm një e keqe e madhe që pllakosi popullin shqiptar.

Nga ana tjetër, edhe vetë shkatërrimi i strukturave të shtetit totalitar socialist nuk mund të mos shoqërohej nga një e keqe tjetër e madhe, d.m.th. nga një periudhë e përkohshme anarkie, sepse atyre grupeve shoqërore dhe individëve që e realizuan këtë përmbyse, veç të tjerave, u mungonin “mekanizmat” psikokulturor të vetëkontrollit që vihen në lëvizje nga forca e besimit në autoritetin hyjnor. Duke analizuar dhe parashikuar modelet e sjelljes së njerëzve në situata të tilla politike e sociokulturore, At Ambroz Marlaskaj arsyetonte: “Fuqia ngjate derisa të ngjasë shtrëngesa e jo ma tepër e prandaj, po nuk u shty njeri me iu shtrëng autoritetit prej një parimi të përbrendshëm, por posa të kalojë shtrëngesa, ka për t’u lshue në jetë të vet... tuj kalue çdo cak... e mandej ktu fillo edhe demoralizimin e shkatërrimi...”⁴. Përvoja e zhvillimeve demokratike postkomuniste në vendin tonë provoi katërcipërisht këtë përfundim me vlerë historike përgjithësuese. Shumë shqiptare të çliruar nga funksionimi i strukturave kontrolluese, imponuese e dhunuese të diktaturës së proletariatit, pa kurrfarë vetëkontrolli, dhunuan dhe dhunojnë çdo normë morale e ligjore në përpjekjet makute për t’u pasuruar sa më shumë e sa

² Ambroz Marlaskaj, *Një monument historik pazotësie në lamë t’arsimit në Shqipëri*, Shkodër, 1922, f. 15.

³ John Mocionis, *Sociology*, New Jersey, 2005, f. 68.

⁴ Ambroz Marlaskaj, *Trajtimi i “Karakterit”*, revista “Hylli i Dritës”, 1923, f. 80.

më shpejt, duke nëpërkëmbur jo rrallë herë të drejtat themelore, nderin e dinjitetin e të tjerëve, madje edhe të njerëzve të afërm. Vetëkontrolli i dobët ose mungesa e konsolidimit të mjaft shqiptarë jo vetëm pengon konsolidimin e demokracisë në vendin tonë, por përbën edhe një premisë për procese anarkike problematike, sidomos në momentet e dobësimit të autoritetit të strukturave shtetërore kontrolluese.

Gjithashtu, qysh në fillim të viteve '20 të shekullit XX ai trajtoi edhe rolin e besimit në zhvillimin e kulturës evropiane. Mjaft prej ideve e argumentimeve të parashtruara për këtë çështje kanë vlerë edhe për zhvillimin e kulturës shqiptare të ditëve tona.

At Ambroz Marlaskaj ishte antikonformist, kritikues aktiv i mangësive, i gabimeve dhe i fajeve në veprimtarinë e çdo individit, të çdo organizimi shoqëror dhe politik; arsimor dhe kulturor. Ndoshta te ky kundërkonformizëm duhen kërkuar rrënjët e lënies në harresë të veprës së tij prej gjithë strukturave zyrtare deri në fillimet e proceseve demokratike postkomuniste në vendin tonë. Ndërkohë që në vitet '20 e '30 të shekullit XX mjaft intelektualë të shquar të Evropës përkrahën idenë e diktaturës së ndritur, që u sendërtua në jetën praktike politike si diktaturë fashiste ose naziste, At Ambroz Marlaskaj afishohej teorikisht e praktikisht si kundërshtar aktiv i çdo diktature politike, shoqërore e shpirtërore. Por kundërkonformizmi i tij nuk kishte asgjë të përbashkët me kokëfortësinë kryeneçe. Ai buronte nga maturia dhe formimi kulturor erudit i tij, nga ndjenja e drejtësisë dhe dëshira e tij fisnike për një organizim shoqëror dhe shtetëror modern që do të siguronte përparimin e shpejtë të popullit tonë, rreshtimin e tij përkrah kombeve më të qytetëruar të Evropës. "... të marrë vesht i madh e i vogël, i dijshtëm e i padijshtëm, der armiq të t'ynë – shkruante ai – se Qeveria nuk asht... e nuk duhet të jetë e drejtue me prej hatërit, prej pajës, prej fanatizmit, por vetëm prej ligjës e drejtësisë"⁵. Me gjithë përpjekjet që kanë bërë e bëjnë shqiptarët përgjatë zhvillimeve demokratike postkomuniste për ndërtimin e shtetit ligjor të së drejtës, ende në shoqërinë shqiptare nuk është realizuar ky vizion – porosi e At Ambroz Marlaskajt. Strukturat shtetërore të shoqërisë shqiptare, vazhdojnë të jenë të infektuara nga ato patologji sociale të diagnostikuara nga ky mendimtar erudit, siç janë hatërllëqet, nepotizmi, fanatizmi partiak etj.

⁵ Ambroz Marlaskaj, *A asht qeveria e Tiranës një "Turki e re" a jo*, në: revista "Hylli i Dritës", 1921, f. 290.

Edhe në rrethanat tejet të vështira të një shoqërie të pastabilizuar ekonomikisht, politikisht e kulturalisht, At Ambroz Marlaskaj ka qenë një nga predikuesit aktivë më të shquar jo vetëm të idesë së shtetit ligjor të së drejtës, por edhe i tolerancës, i mirëkuptimit ndërmjet shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Në vitet 1921-1923 në Shqipëri u organizuan kuvende e kongrese të myslimanëve bektashi e syni. Një pjesë e shtypit, madje edhe disa klerikë u përpoqën t'i interpretonin veprimtari të tilla si “dekadencë të mnershme”, si “anmike të përparimit e të qytetnisë”, si “fanatizëm të randë e të damshëm”⁶. Duke i kritikuar paragjykime të tilla për myslimanët shqiptarë që në fillesat e tyre, At Ambroz Marlaskaj shkruante: “... bashkëveprimi i nënshtetasve shqiptar të mos ndalohet kurrë një pikë për ndryshime besimi...”⁷. Madje, edhe shkrimet polemizuese të këtij dijetari mendjendritur e të urtë, që përshkoheshin nga respektimi me dinjitet i çdo mendimi të ndryshëm deri krejt të kundërt, kanë shërbyer e shërbejnë si një shkollë e madhe e kultivimit të ndjenjës fisnike të tolerancës mirëkuptuese. Duke vënë në dukje këto tipare të karakterit, të personalitetit dhe të veprimtarisë së gjithanshme të At Ambroz Marlaskajt, Gjon Kamsi shkruante në revistën “Hylli i Dritës”. “Predikëtar i fuqishëm, pat fjalën e rrjedhët e të bindshme. Prekte e ngjitëte fjala e tij, zgjonte mendet e kotullueme, zbutëte zemrat e forta dhe të gjithë i ndezte në dashtni për Atdhë e për vepra e fille fisnike. Luftar, me të vetmen armë të të drejtës, s’u u-përkul as miklimevet, as frigsimevet të të fuqishmit, por qindroi si burrë shqiptar, i drashtun prej anmiqvet, jo të tij; pse ai s’pat anmiq të vet, por t’idealit të tij, dhe i dashtun e i nderuem prej të gjithë atyne qi e njoften, që ia kishin ndie zânin dhe q’e çmofshin për atdhetar të kulluet”⁸.

At Ambroz Marlaskaj i ka kundërkritikuar gjithnjë paragjykimet e pikëpamjet që përpiqeshin t'i armiqësonin shqiptarët e krahinore veriore me ata të krahinave jugore, gegët me toskët. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur në sallën e Bashkisë së Vlorës më 2 maj 1924 me rastin e varrimit të Avni Rustemit dhe përgatitjeve të grupimit liberal për të ndryshuar me dhunë qeverinë, At Ambroz Marlaskaj kritikoi ashpër pikëpamjet e disa pjesëmarrësve, se gjoja banorët e

⁶ *Po aty.*

⁷ Gazeta “Populli”, datë 09.03.1923.

⁸ A. Marlaskaj, *A asht qeveria e Tiranës*, f. 291.

krahinave jugore nuk mund të lidheshin lehtë me ato të viseve të veriut. Që këtu, theksoi ai, “ma parë shkojnë në Shkodër se në Lushnjë”⁹.

Harmonia, mirëkuptimi ndërmjet shqiptarëve pa dallim feje, krahine apo orientimi ideopolitik ka patur dhe ka rëndësi të veçantë. Një mirëkuptim të tillë At Ambroz Marlaskaj do ta konsideronte si faktor kryesor për zgjidhjen e drejtë të çështjeve mbarëkombëtare, për të përballuar veprimtarinë diversioniste antishqiptare të qarqeve shoviniste të shteteve fqinje. Bashkimi i të Krishterëve dhe i Myslimanëve, theksonte shpesh ai, është një nga çështjet ma t’ mëdha të kombit shqiptar “për me mëkambë e me mbajtë një Shqipni të lirë e të përparueme...”¹⁰.

Mirëkuptimi aq i dëshirueshëm në çdo shoqëri dhe në çdo kohë arrihet vetëm nëse respektohet dinjiteti i çdo individi, vetëm nëse marrëdhëniet ndërmjet njerëzve spastrohen nga ndikimet egoiste dhe përshkohen nga fryma e altruizmit. Të mos veprohet kurrë, shkruante At Marlaskaj, në mënyrë që “për interesa e dobi vetjake të dëmtohen tagret e interesat e të tjerëve, por gjithkujt, të madhit e të voglit, të fortit e të ligshit t’i njihen e t’i nderohen të drejtat...”¹¹.

Arritjet më të vyera të trashëgimisë filozofike dhe sociologjike botërore, të Platonit dhe të Senekës, të Aristotelit dhe të Kantit, të Rusoit dhe të Hegelit, të Dyrhejmit dhe të Veberit etj. At Ambroz Marlaskaj do t’i përdorte me shpirt krijues jo vetëm për të analizuar realitetin shoqëror, ekonomiko-politik e kulturor shqiptar, për të sugjeruar rrugëzgjdhje imediate, afatmesme e afatgjata për probleme të rëndësishme që shtronte koha, por edhe për të arsytuar ligjësitë e zhvillimit të kulturës shqiptare, për të përcaktuar vendin e popullit e të kulturës shqiptare në familjen e kombeve dhe të kulturave evropiane e më gjerë. Nëpërmjet analizave krahasuese të mirargumentuara, At Ambroz Marlaskaj hedh poshtë mjaft psikoza e teorizime të studiuesve të huaj, apo edhe të atyre pak shqiptarëve të çoroditur ose të shitur, që përpiqeshin të mohonin kulturën me vlera aq origjinale dhe përvojën historike vetorganizuese të popullit shqiptar. Ai e vlerësonte trashëgiminë kulturore-historike shqiptare me objektivitet, larg qëndrimeve me natyrë etnocentrike dhe ksenocentrike. “Ne – theksonte ai – jena tuej këndue pa da ndër fletore të botës se sa

⁹ Po ai, *Nji moment historik pazotësie në lamë t’arsimit në Shqipni*, Shkodër, 1933, f. 14.

¹⁰ Gjon Kamsi, *Patër Ambrozi*, në: Revista “Hylli i Dritës”, nr. 3-7, 1939, f. 343.

¹¹ A. Marlaskaj, *A asht qeveria e Tiranës ...*, f. 291.

padrejtësi janë tue ndodhë ndër mbretni e shtete ma të rregullueme e ndryshimi ndërmjet sosh e nesh asht vetun, se ata gabimet i bajën mâ të mëdha, por nuk ka kush interes me i përhapë e me i zmadhue, ndërsa në Shqipni armiqtë për një arsye a për një tjetër mxi presin me gjetë halën më përpeq me e ba mizën buell, për me i dëftue Evropës se shqiptarët nuk janë të zott me sundue vendin, por duhen nda ndër mbretni të Ballkanit¹². Këto pohime rrezatojnë mesazhe me vlerë aktuale jo vetëm në rrafshin politik, por edhe në atë psikokulturor, sepse u kundërvihen mentaliteteve vetëpërçmuese e vetëfajësuese që kanë prekur një masë të konsiderueshme shqiptarësh me formim jo të shëndoshë kulturor e atdhetar, sidomos në kushtet e “hapjes” së vendit tonë, të difuzimit dhe të integritit të kulturës shqiptare në rrjedhën e zhvillimeve evropiane e më gjerë. Kështu, me fakte të shumta, me analiza të gjera krahasuese ndërkulturore dhe me argumentime të pakundërshtueshme në mjaft shkrime të tij, At Ambroz Marlaskaj ngjiz testamentin e lartësimit të krenarisë, të dinjitetit kombëtar të shqiptarëve.

Në këtë artikull të shkurtër vetëm sa cekem fare shkarazi disa maja të korpusit të mendimit filozofik, sociologjik e kulturologjik të At Ambroz Marlaskajt, që është një “emën zâmadh për dije e atdhedashuni¹³. Mendojmë se është detyrim fisnik dhe nder për studiuesit tanë të profileve përkatëse ta studiojnë në gjithë kompleksitetin e vet këtë korpus, jo thjeshtë për të përcaktuar vendin dhe rëndësinë e tij në fondin e trashëgimisë shpirtërore të popullit tonë, por edhe për të vënë në qarkullim kulturor aktiv të gjitha vlerat e tij që ndihmojnë zhvillimet aktuale e perspektive të kulturës shqiptare.

¹² *Rreth vorrit të Avni Rustemit* (Mbledhje të mbajtura në Vlonë në 1 e 2. V. 1924, Stenografue prej Serafin Mazrrekut), Shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1924, f. 42.

¹³ Gj. Kamsi, *vep. e për.*, f. 342.

